



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 nëntor 2024

Nr. Ref.:RK 2578/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI167/24

Parashtrues

N.T.SH. "PATRONI"

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr. 44/2024, të 4 prillit
2024, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.T.SH. "Patroni" (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Naim Spahiu, avokat në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr. 44/2024], e 4 prillit 2024, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.518/24], e 7 marsit 2024, të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale - Shkalla e Dytë) dhe Aktvendimin [KA.nr. 66/24], e 5 shkurtit 2024, të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale - Shkalla e Parë).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr. 44/2024], të 4 prillit 2024, të Gjykatës Supreme përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrotjtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 korrik 2024, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 gusht 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr.GJR.KI167/24] caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [nr.KSH.KI167/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 15 gusht 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 30 tetor 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se në vitin 2013, parashtruesi i kërkesës nënshkroi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejme: MBPZHR) Kontratë për qira të tokës bujqësore, pronë e MBPZHR-së, respektivisht për parcelën kadastrale nr. 2916 e klasit të parë (I-rë) në sipërfaqe prej 0,25 h (njëzet e pesë ari) (në tekstin e mëtejme: prona kontestuese) me çmim prej 20 (njëzet) euro për ari,

respektivisht 500 (pesëqind) euro për muaj, për kohëzgjatjen prej 1 shtatorit 2013 deri më 31 gusht 2018, e cila Kontratë pastaj ishte vazhduar për periudhën nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2023. Bazuar në pikën 1.7 të nenit 6 (Ndërprerja e kontratës) të Kontratës, e njëjta ndërpritet, mes tjerash, “*Me skadimin e afatit të kontratës*” ndërsa bazuar në pikën 6 të nenit 4 (Obligimet e Qiramarrësit) të Kontratës parashihej, mes tjerash, se “*Pas skadimit të afatit të caktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, qiramarrësi obligohet që parcelën e marrë me qira t’ia kthej qiradhënësit në gjendjen e mëparshme.*”

Procedura përkitazi me njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga MBPZHR për skadimin e Kontratës për dhënien me qira të pronës kontestuese

10. Më 25 tetor 2023, 13 dhjetor 2023 si dhe 3 janar 2024, MBPZHR e paralajmëroi parashtruesin e kërkesës për skadimin e Kontratës për dhënien me qira të pronës kontestuese dhe i kërkoi t’ia lirojë të njëjtën deri më 1 janar 2024.
11. Më 6 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesë parashtroi (i) padi për kompensim të dëmit; me (ii) propozim për caktimin e masës së sigurisë, të cilën e precizoi më 14 dhjetor 2023 duke kërkuar që MBPZHR të mos ndërmarrë asnjë veprim për lirimin e parcelës së dhënë me qira dhe që këtë vendim ta respektojë deri në marrjen e një vendimi meritator të çështjes.
12. Më 27 dhjetor 2023, Gjykata Komerciale – Shkalla e Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, përmes Aktvendimit [KE.nr.973/23], refuzoi në tërësi propozimin e masës së sigurimit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit sepse, mes tjerash, e njëjta përbën kërkesë e cila do të jetë objekt i shqyrtimit të padisë. Kjo procedurë nuk kontestohet para Gjykatës.

Procedura përkitazi me njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga MBPZHR për lirimin e pronës kontestuese nga parashtruesi i kërkesës, e cila procedurë kontestohet para Gjykatës

13. Më 29 janar 2024, MBPZHR përmes Vendimit [Ref.KM-49/24], ndër të tjera, vendosi që lirim i parcelës së lartcekur do të bëhej më 1 shkurt 2024, me fillim nga ora 12:00.
14. Më 31 janar 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Komerciale – Shkalla e parë (i) padi për inicimin e konfliktit administrativ kundër Vendimit [Ref.KM-49/24], të 29 janarit 2024; dhe (ii) kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartcekur të MBPZHR-së, të cilës kërkesë, sipas parashtruesit të kërkesës, ia bashkëngjiti provat në vijim: (a) fotografitë e pompës së derivateve të parashtruesit dhe restorantit; (b) listën e punëtorëve në këtë pikë të derivateve; si dhe (c) dëshmitë e investimeve financiare të kryera, me arsyetimin se ekzekutimi i vendimit të kontestuar do t’i sillte dëme të pariparueshme për shkak të investimit në vlera të mëdha financiare.
15. Më 5 shkurt 2024, Gjykata Komerciale – Shkalla e Parë, përmes Aktvendimit [KA.nr. 66/24], (i) aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së derisa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e tij, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës kishte investuar në parcelën e dhënë me qira duke ndërtuar pompën e derivateve dhe restorantin dhe kishte të punësuar punëtorë që marrin paga nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik të parashtruesit të kërkesës.

16. Më 13 shkurt 2024, MBPZHR parashtroi ankesë kundër Aktvendimit [KA.nr. 66/24], të 5 shkurtit 2024, të Gjykatës Komerciale – Shkalla e Parë, të cilën ankesë e plotësoi më 20 shkurt 2024.
17. Më 23 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë me propozimin që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e MBPZHR-së dhe të vërtetohet aktvendimi i lartcekur.
18. Më 7 mars 2024, Gjykata Komerciale – Shkalla e Dytë, përmes Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.518/24], (i) aprovoi ankesën e MBPZHR-së; (ii) ndryshoi Aktvendimin [KA.nr.66/24], të 5 shkurtit 2024, të shkallës së parë ashtu që (iii) refuzoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit [Ref.KM-49], të 29 janarit 2024, të MBPZHR-së, me arsyetimin se (i) parashtruesi nuk kishte arritur të vërtetojë me prova dhe fakte kushtin e shkaktimit të dëmit, respektivisht, investimet e tij dhe numrin e madh të punëtorëve sepse kishte paraqitur vetëm kontratat; kërkesat për vazhdimin e qirasë; dhe vendimin e kontestuar të MBPZHR-së; dhe se (ii) MBPZHR synoi lirimin e parcelës së dhënë me qira, si rezultat i një raporti juridik-civil, të cilin nuk kishte për qëllim ta vazhdojë, pa paragjykim të vlerësimit meritore të ligjshmërisë së këtij akti administrativ.
19. Më 18 mars 2024, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.518/24], të 7 marsit 2024, të Gjykatës Komerciale – Shkalla e Dytë parashtroi kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme. Në kërkesën e tij, parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se gjykata e shkallës së dytë: (i) ka vendosur çështjen kryesore të kërkesëpadisë kur ka konstatuar se *“është i pamohueshëm fakti se qëllimi i organit administrativ është për ta përfunduar raportin juridik”*; (ii) nuk i ka vlerësuar provat përkitazi me kushtin ligjor të shkaktimit të dëmit, të cilat i kishte paraqitur me rastin e parashtrimit të padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit lidhur me numrin e madh të punëtorëve dhe investimeve të mëdha; si dhe (iv) nuk e ka arsyetuar pranimin e provave të MBPZHR-së, të paraqitura me rastin e plotësimit të ankesës më 20 shkurt 2024, të cilat nuk i ka paraqitur në fazat e mëhershme të procedurës siç e parashohin dispozitat e procedurës administrative.
20. Më 4 prill 2024, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr.44/2024], refuzoi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruesit, me arsyetimin se, në esencë, nuk ekzistojnë provat se në mënyrë kumulative janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i vërtetojë as me prova e as me fakte pretendimet e tij për shtyrjen e ekzekutimit për shkak të investimeve të mëdha dhe numrit të madh të punëtorëve, sipas të cilave kjo gjykatë do të mund ta vlerësonte kriterin e shkaktimit të dëmit. Për më tepër, Gjykata Supreme vlerësoi se MBPZHR-ja paraqiti prova për ekzistimin e interesit publik, ndër të tjera, (i) pagesën e qirasë mujore në vlerë prej 54,000 (pesëdhjetekatër mijë) euro në muaj si pasojë e mosshfrytëzimit të pronës së saj, si dhe (ii) planin e saj për të ndërtuar një objekt në parcelën e dhënë me qira, me çka rrezikon të humbë grantin investues për ndërtimin e të njëjtit.

Procedura për lirimin e pronës kontestuese të zhvilluara nga Kryeinspektori i Departamentit Qendror të Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti i MBPZHR-së

21. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 25 mars 2024, Kryeinspektori i Departamentit Qendror të Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti pranë MBPZHR-së, përmes Aktvendimit [nr. 154/2024], obligoi parashtruesin e kërkesës që të bëjë lirimin e parcelës së dhënë me qira sipas Vendimit [Ref.KM-49/24], të 29 janarit 2024, të MBPZHR-së.
22. Më 8 prill 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktvendimit [nr. 154/2024], të 25 marsit 2024, të Kryeinspektorit të Departamentit Qendror të

Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti pranë MBPZHR-së. Kjo procedurë nuk kontestohet para Gjykatës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenit 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së.
24. Fillimisht, parashtruesi thekson se kërkesa e tij i përmbushë kriteret e pranueshmërisë para Gjykatës, të përcaktuar me Ligj dhe Rregulloren e Punës, përfshirë, aplikimin e nenit 31 të Kushtetutës në procedurat paraprake në përputhje me kriterin e pajtueshmërisë *ratione materiae*, me ç'rast i referohet praktikës gjyqësore të vet Gjykatës, respektivisht, rastit [KI122/17](#) [me parashtrues *Česká Exportní Banka A.S*, Aktgjykim i 18 prillit 2018].
25. Parashtruesi në thelb konsideron se Aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në shkelljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të: (i) zbatimit “*arbitrar e të paarsyeshëm*” të ligjit; si dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.
26. Përkitazi me pretendimin për zbatimin arbitrar të ligjit, parashtruesi thekson se: (i) sa i përket kushtit të parë ligjor për shkaktimin e dëmit, Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Shkalla e Dytë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i kanë mohuar dhe injoruar provat e paraqitura nga ai për të dëshmuar investimet e mëdha dhe numrin e madh të të punësuarve, të cilat ia kishte bashkëngjitur padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, si në vijim: (a) fotografitë e pompës së derivateve të parashtruesit dhe restorantit; (b) listën e punëtorëve në këtë pikë të derivateve; si dhe (c) dëshmitë e investimeve financiare të kryera; ndërsa (ii) sa i përket kushtit të dytë dhe të tretë ligjor, gjegjësisht shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe se nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare, konsideron se i njëjti do të vazhdojë t'ia paguajë qiranë sipas obligimeve kontraktuale dhe në rast të shkaktimit të dëmit eventual, MBPZHR mund të kërkojë kompensimin e tij në procedura civile.
27. Në këtë kontekst, parashtruesi po ashtu vlerëson se gjykatat e lartcekura kanë vepruar në kundërshtim me nenin 63 (Dispozitat e tjera të procedurës) të LKA-së në lidhje me paragrafin 1 të nenit 180 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), ku parashihet se në ankesë nuk mund të propozohen prova të reja, dhe se në lidhje me këtë, provat që MBPZHR i ka paraqitur në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore përkitazi me interesin publik dhe dëmin e palës kundërshtare, Gjykata Komerciale – Shkalla e Dytë dhe ajo Supreme, nuk e kanë marrë parasysh që MBPZHR-ja nuk i ka paraqitur para gjykatës së shkallës së parë.
28. Për më tepër, parashtruesi konsideron se nëse mbetet në fuqi Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme deri në vendosjen meritore të çështjes, atij do t'i shkaktohet dëm i madh i pariparueshëm sepse (i) do të detyrohet t'i largojë nga puna 24 (njëzetekatër) punëtorë; (ii) do t'i dëmtohet investimi prej 1,526.610.65 euro (një milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë euro pikë gjashtëdhjetë e pesë cent); si dhe (iii) do t'i dëmtohet rëndë reputacioni dhe “*goodwilli*”, i cili do të jetë i pa llogaritshëm nga aspekti material.
29. Përkitazi me pretendimin për mungesë të vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme nuk ka adresuar pretendimet ankimore të tij të ngritura në kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjegjësisht me

pretendimet se gjykata e shkallës së dytë: (i) ka vendosur çështjen kryesore të kërkesëpadisë kur ka konstatuar se “*është i pamohueshëm fakti se qëllimi i organit administrativ është për ta përfunduar raportin juridik*”, marrë parasysh se ky konstatim bie jashtë juridiksionit të saj për të vendosur në lidhje me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ; (ii) nuk i ka vlerësuar provat përkitazi me kushtin ligjor të shkaktimit të dëmit, të cilat i kishte paraqitur me rastin e parashtrimit të padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit lidhur me numrin e madh të punëtorëve dhe investimeve të mëdha; (iii) në mënyrë kontradiktore, në po të njëjtin arsyetim të Aktvendimit, e ka kualifikuar njëherë raportin juridik mes parashtruesit dhe MBPZHR-së si raport juridiko-detyrimor, e më pas gabimisht si raport juridik-administrativ; si dhe (iv) nuk e ka arsyetuar pranimin e provave të MBPZHR-së, të paraqitura me rastin e plotësimit të ankesës më 20 shkurt 2024, të cilat nuk i ka paraqitur në fazat e mëhershme të procedurës siç e parashohin dispozitat e procedurës administrative.

30. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesi konsideron se Aktgjykimi i kontestuar përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në të drejtën e pronës së tij, me ç'rast i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, respektivisht rasteve të GJEDNJ-së, *Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, nr. 10873/84, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, *Pressos Campania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr.17849/91, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995; *Capital Bank Ad kundër Bullgarisë*, nr. 49429/99, Aktgjykim i 24 nëntorit 2005; *Sporrong dhe Lonroth kundër Suedisë*, nr. 7151/75 dhe nr. 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982; *Saliba kundër Maltës*, nr. 4251/02, Aktgjykim i 8 nëntorit 2005, nga ku konstaton se koncepti i pronësisë përfshinë një gamë të gjerë të të drejtave që rrjedhin nga licencat dhe po ashtu nga drejtimi i një biznesi, si dhe që një kërkesë për kompensim mund të konsistojë në pasuri për shkak të pritjeve legjitime që një kërkesë e tillë të realizohet.
31. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se duke pasur parasysh zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe mungesën e arsytimit bindës në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, nuk ka pasur garanci të mjaftueshme ndaj arbitraritetit të Gjykatës Supreme dhe kjo ka rezultuar në shkelje të së drejtës së tij të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) ta shpallë të pranueshme kërkesën; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iv) ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme; si dhe (v) ta kthejë në rishqyrtim këtë Aktgjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]”

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

- “1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj”.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]

Neni 6
(E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...].”

Protokolli Shtesë nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [i miratuar më 20 mars 1952 nga Këshilli i Evropës]

Neni 1
(Mbrojtja e pronës)

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 16
(pa titull)

- “1. Akti administrativ përfundimtar mund të kundërshtohet:*
1.1. për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore;
1.2 . për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent;
1.3. për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;
1.4. për shkak se me aktin përfundimtar administrativ i nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkaluar kufijtë e autorizimit ligjor ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji;
1.5. për shkak se pala e paditur e ka nxjerrë përsëri aktin e vetë të mëhershëm, më parë të anuluar me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës kompetente.
2. Akti administrativ nuk mund të kundërshtohet për aplikim jo të drejtë të dispozitave, kur organi kompetent ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në bazë të autorizimeve dhe në kuadrin e kufijve që i janë dhënë me dispozitat ligjore, në pajtim me qëllimin për të cilin i është dhënë autorizimi.”

Neni 22 (pa titull)

- “1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.*
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.
4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.
5. Organi nga paragrafi 2. i këtij neni mund të shtyjë ekzekutimin e aktit të kontestuar edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse nuk është në kundërshtim me interesin publik.
6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni. 7. Për kërkesën, gjykata vendos brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.”

Neni 63 (Dispozita të tjera të procedurës)

“Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshatshëmrisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.”

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 180 (pa titull)

“180.1 Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë,

përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë.

*180.2 Duke i treguar faktet e reja, ankuesi ka për detyrë që t'i përmendë provat me të cilat faktet e tilla do të vërtetoheshin, kurse duke i treguar provat e reja, ka për detyrë t'i përmendë faktet të cilat me provat e tilla duhet vërtetuar.
[...]"*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe nenit 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin për shterjen e mjeteve juridike dhe që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pikat (b) dhe (d) të paragrafit 1 dhe paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës, përcaktojnë që:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) Janë shteruar te gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktit te kontestuar;

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

37. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. [KI41/09](#), parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe [KI35/18](#), me parashtrues *"Bayerische Versicherungsverband"*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
38. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr. 44/2024], e 4 prillit 2024, të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.518/24], e 7 marsit 2024, të Gjykatës Komerciale - Shkalla e Dytë dhe Aktvendimin [KA.nr. 66/24], e 5 shkurtit 2024, të Gjykatës Komerciale – Shkalla e Parë; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; si dhe (iv) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
39. Në mënyrë që Gjykata të vazhdojë vlerësimin e kriterëve tjerë të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata rikujton që në rastin e parashtruesit janë zhvilluar 3 (tri) procedura:
- a) Procedura e parë ndërlihet me kërkesëpadinë e parashtruesit për kompensim të dëmit kundër MBPZHR-së, me ç'rast kishte propozuar edhe vendosjen e masës së sigurimit, i cili propozim më 29 dhjetor 2023, iu kishte refuzuar nga Gjykata Komerciale (Shkalla e Parë), procedurë për të cilën, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata nuk ka njohuri nëse është vendosur.
- b) Procedura e dytë ndërlihet me (i) kërkesëpadinë e parashtruesit për konflikt administrativ kundër vendimit të MBPZHR-së për lirim të pronës, të cilën ia kishte dhënë me qira në shfrytëzim përmes një kontrate, afati i së cilës kishte skaduar. Së bashku me kërkesëpadinë, parashtruesi i kërkesës (ii) kishte parashtruar edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi për shkak të dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktohej, e cila kërkesë në procedurë paraprake nga gjykata e shkallës së parë i ishte aprovuar, ndërsa nga ajo e shkallës së dytë në kuadër të Gjykatës Komerciale, sipas ankesës së MBPZHR-së, Aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë i ishte ndryshuar ashtu që kërkesa e parashtruesit për shtyrjen e

ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së i ishte refuzuar. Gjykata Supreme po ashtu vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Shkalla e Dytë; si dhe

- c) Procedura e tretë ndërlidhet me ankesën e parashtruesit kundër Aktvendimit [nr. 154/2024], të 25 marsit 2024, të Kryeinspektorit të Departamentit Qendror të Inspeksionit për Pyltari dhe Gjueti pranë MBPZHR-së.
40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston procedurën e dytë, për të cilën, në thelb, pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me (i) nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të: (a) zbatimit arbitrar të ligjit, respektivisht dispozitave të LKA-së në lidhje me përmbushjen e kriterëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ; dhe (b) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor; si dhe (ii) me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, për shkak të ndërhyrjes në të drejtën e tij të pronës, respektivisht në investimet e tij në parcelën e dhënë me qira.
41. Nga si më sipër, Gjykata, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe plotësimin e kriterëve tjera të pranueshmërisë përkitazi (i) me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, respektivisht pretendimet specifike në lidhje me (a) zbatimin arbitrar të ligjit; dhe (b) mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor; si dhe (ii) të drejtën e pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

I. Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

42. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, duke marrë parasysh që vendimi i kontestuar para Gjykatës ndërlidhet me Aktvendimet përkitazi (i) me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ si masën e sigurisë, përkatësisht "*procedurën paraprake*"; kurse (ii) kërkesëpadia lidhur me objektin e kontestit gjendet akoma në procedurë të shqyrtimit të meritave nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm.
43. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren fillimisht se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, respektivisht, parimet e përgjithshme janë vendosur në rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, Aktgjykim, i 15 tetorit 2009, të cilën praktikë edhe Gjykata Kushtetuese e ka aplikuar, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet: KI122/17, me parashtrues, *Ceska Exportni Banka A.S.*, cituar më lart; [KI150/16](#), parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim, i 31 dhjetorit 2018; [KI81/19](#), parashtrues *Skender Podrimqaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 nëntorit 2019; [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020; si dhe [KI195/20](#) me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021.
44. Bazuar në praktikën gjyqësore të saj dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë/masat e përkohshme përcaktojnë të drejta ose detyrime civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në "*proceduarat paraprake*" (shih, rastin e Gjykatës KI75/21, me parashtrues "*Abrazen LLC*", "*Energy Development Group Kosova LLC*", "*Alsi & Co. Kosove LLC*" dhe "*Building Construction LLC*", Aktvendim për papranueshmëri, i 19 janarit 2024,

paragrafi 58; dhe rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).

45. Sipas kritereve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë "*civile*" si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe; së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 84 dhe 85 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës KI122/17, parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafët 130 dhe 131; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafët 47 dhe 48; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, të cituar më lart, paragrafi 53).
46. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës i referohen vendimeve të kontestuara të Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Supreme, në lidhje me refuzimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, respektivisht Vendimi [Ref.KM-49/24], të 29 janarit 2024, kundër palës së paditur, MBPZHR, me arsyetimin se ekzekutimi i vendimit të kontestuar do t'i sillte dëme të pariparueshme për shkak të (i) investimit në vlera të mëdha financiare; (ii) numrit të madh të punëtorëve që do të mbetnin pa punë; si dhe (ii) cenimit të reputacionit.
47. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës (i) gëzon një të "*drejtë civile*" që vë në lëvizje garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën; dhe, se (iii) garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshme në këtë rast.
48. Në vijim, Gjykata rithekson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës do t'i vlerësojë vetëm për sa i përket procedurës paraprake të kësaj kërkeje, përmes vendimeve të gjykatave të rregullta lidhur me refuzimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.
49. Duke qenë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ndërlidhen me shkeljen e garancive procedurale të kësaj të drejte, respektivisht, (i) zbatimit arbitrar të ligjit; dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, në vijim, Gjykata do të trajtojë veç e veç pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës.
50. Gjykata, lidhur me këtë thekson se rregulli 34, paragrafi 2, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të*

paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim, i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim, i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonisë](#), nr. 71074/01, Vendim, i 7 dhjetorit 2004, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim, i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtuese Nexhmije Makolli, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [KI107/21](#), parashtues Ramiz Hoti, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [KI05/23](#) parashtues Branislav Gajin, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).

(i) *Vlerësimi i pretendimeve përkitazi me zbatimin arbitrar të ligjit*

51. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtues Belgjyzar Latifi, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtues Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., “Adem Jashari”, Aktvendim, i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), parashtuese Lumturije Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), parashtues, Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; [KI76/21](#), parashtues Qemajl Babuni, Aktvendim, i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34; [KI188/21](#), me parashtues Zenel dhe Isuf Pllashniku, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafët 98-99; [KI31/22](#), me parashtues Fidan Hoti, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 janarit 2023, paragrafët 43-44, [KI89/22](#), parashtues Xhelal Plakolli, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 marsit 2023, paragrafi 42, [KI79/24](#), parashtues Ali Xhigoli dhe Naser Xhigoli, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 qershorit 2024, paragrafi 48).
52. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi; dhe rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), rast i cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), raste të cituara më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtues Qemajl Babuni, rast i cituar më lart, paragrafi 35; [KI31/22](#), me parashtues Fidan Hoti, cituar më lart, paragrafi 42, [KI89/22](#), parashtues Xhelal Plakolli, cituar më lart, paragrafi 43).
53. Gjykata mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në “konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme” (shih, rastin e Gjykatës [KI75/17](#), parashtues X, Aktgjykim, i 30 janarit 2018, paragrafi 59; dhe [KI89/22](#), parashtues Xhelal Plakolli, cituar më lart, paragrafi 44).
54. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, përkitazi me pretendimin e parashtuesit të kërkesës për zbatimin arbitrar të ligjit, respektivisht të dispozitave të LKA-së në lidhje

me përmbushjen e kriterëve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, Gjykata fillimisht rikujton kushtet ligjore që duhet plotësuar për shtyrjen e ekzekutimit të një akti deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas paragrafit 2 të nenit 22 të LKA-së i cili përcakton se: *"Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar."*

55. Gjykata vëren se sipas dispozitave relevante të cekura më lart, shtyrja e ekzekutimit të një akti, mund të vendoset nëse plotësohen në mënyrë kumulative kushtet në vijim:
 - (i) ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej;
 - (ii) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe
 - (iii) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.
56. Gjykata rikujton se Gjykata Komerciale – Shkalla e Parë aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së për lirimin e pronës publike, me arsyetimin se në rastin konkret përmbushet kushti ligjor për shkaktimin e dëmit sepse parashtruesi i kërkesës kishte investuar në parcelën e dhënë me qira duke ndërtuar pompën e derivateve dhe restorantin dhe kishte të punësuar punëtorë që marrin paga nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik të parashtruesit, bazuar në kontratën e lidhur me MBPZHR-në.
57. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe Aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Shkalla e Dytë, e cila aprovoi ankesën e MBPZHR-së, dhe e ndryshoi Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e refuzuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së; dhe Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila pranoi arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë në rastin konkret, dhe konstatoi se nuk ekzistojnë provat se në mënyrë kumulative janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ pasi (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i vërtetojë as me prova e as me fakte pretendimet e tij për shtyrjen e ekzekutimit për shkak të investimeve të mëdha dhe numrit të madh të punëtorëve, sipas të cilave kjo gjykatë do të mund ta vlerësonte kriterin e shkaktimit të dëmit; (ii) pala e paditur nga parashtruesi, gjegjësisht, MBPZHR paraqiti prova për ekzistimin e interesit publik, ndër të tjera, (i) planin e saj për të ndërtuar një objekt në parcelën e dhënë me qira, me çka rrezikon të humb grantin investues për ndërtimin e të njëjtit; si dhe (ii) pagesën e qirasë mujore nga MBPZHR në vlerë prej 54,000 (pesëdhjetekatër mijë) euro në muaj si pasojë e mosshfrytëzimit të pronës së saj.
58. Gjykata vëren se në thelb, gjykatat e rregullta, respektivisht, Gjykata Komerciale – Shkalla e Dytë dhe Gjykata Supreme, kishin vlerësuar se bazuar në të lartcekurat, rezulton se kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nuk ishin plotësuar, përfshirë për shkak se shtyrja do t'i sillte dëm palës kundërshtare, përkatësisht MBPZHR-së pasi kjo e fundit (i) kishte planin e saj për të ndërtuar një objekt në atë parcelë përmes financimit nga një grant investues; pasi (ii) paguan qira në vlerë prej 54,000 (pesëdhjetekatërmijë) euro për shkak të mos shfrytëzimit të parcelës së dhënë me qira. Rrjedhimisht, nuk ishin plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e zbatimit të vendimit të kontestuar.
59. Prandaj, Gjykata vlerëson se nga arsyetimi i konkluzioneve të Gjykatës Komerciale – Shkalla e Dytë dhe Gjykatës Supreme, në dritën e rrethanave të rastit konkret, nuk kemi

të bëjmë as me “*aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*” dhe as me “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” nga ana e Gjykatës Supreme.

60. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për zbatimin arbitrar të ligjit është pretendim që bien në kategorinë e pretendimeve me “*mungesë evidente apo të dukshme të shkeljes*” dhe si i tillë, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(ii) *Vlerësimi i pretendimeve përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor*

61. Sa i përket të drejtës për vendim të arsyetuar, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së të cilën e ka përvetësuar edhe Gjykata, rezulton, mes tjerash, se (i) garancitë e mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenin 31 të Kushtetutës, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre; (ii) vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë; (iii) gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'ua mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës; (iv) paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument; dhe se (v) nga natyra e vendimit që merr, varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjytimeve (për një elaborim më të detajuar përkitazi me parimet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, shih rastet e GJEDNJ-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim, i 1 korrikut 2003, paragrafi 34; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim, i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; si dhe rastet e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafët 113-124; dhe [KI164/23](#), [KI173/23](#), [KI174/23](#), [KI175/23](#), [KI176/23](#) dhe [KI201/23](#), parashtrues *Murat Syla, Gentian Syla, Shqipe Kelmendi, Rinor Sogojeva, Asdren Mustafaj, dhe Besnik Elshani*, cituar më lart, paragrafët 148-150).

62. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata ripërsërit se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka adresuar pretendimet ankimore të tij të ngritura në kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjegjësisht me pretendimet se gjykata e shkallës së dytë: (i) ka vendosur çështjen kryesore të kërkesëpadisë kur ka konstatuar se “*është i pamohueshëm fakti se qëllimi i organit administrativ është për ta përfunduar raportin juridik*”, marrë parasysh se ky konstatim bie jashtë juridiksionit të saj për të vendosur në lidhje me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ; (ii) nuk i ka vlerësuar provat përkitazi me kushtin ligjor të shkakutimit të dëmit, të cilat i kishte paraqitur me rastin e parashtrimit të padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit lidhur me numrin e madh të punëtorëve dhe investimeve të mëdha; (iii) në mënyrë kontradiktore, në po të njëjtin arsyetim të Aktvendimit, e ka kualifikuar njëherë raportin juridik mes parashtruesit dhe MBPZHR-së si raport juridiko-detyrimor, e më pas gabimisht si raport juridik-administrativ; si dhe (iv) nuk e ka arsyetuar pranimin e provave të MBPZHR-së, të paraqitura me rastin e plotësimit

të ankesës më 20 shkurt 2024, të cilat nuk i ka paraqitur në fazat e mëhershme të procedurës, siç e parashohin dispozitat e procedurës administrative dhe kontestimore, respektivisht nenit 63 (Dispozitat e tjera të procedurës) i LKA-së në lidhje me nenin 180 (pa titull) të LPK-së.

63. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së dytë dhe Gjykata Supreme nuk i kanë vlerësuar provat përkitazi me përmbushjen e kushteve ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, dhe më specifiku kushtit ligjor të shkaktimit të dëmit, të cilat i kishte paraqitur me rastin e parashtrimit të padisë dhe kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit lidhur me numrin e madh të punëtorëve dhe investimeve të mëdha, Gjykata konstatoi më lart se këto pretendime bien në kategorinë e pretendimeve në *“mungesë evidente apo të dukshme të shkeljes”* dhe si të tilla, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
64. Në anën tjetër, përkitazi me adresimin e pretendimit të parashtruesit që e kishte ngritur në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor për shkeljen e nenit 63 (Dispozitat e tjera të procedurës) të LKA-së në lidhje paragrafin 1 të nenit 180 (pa titull) të LPK-së, pasi sipas tij, sa i përket provave të reja të cilat nuk janë paraqitur në shkallën e parë, Gjykata vlerëson se përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar si Gjykata e Apelit i kishte dhënë rëndësi provave të paraqitura nga e paditura përmes plotësimit të ankesës por nuk kanë dëshmuar se këto ishin prova që kishin rëndësi vendimtare për të vlerësuar (i) interesin publik dhe (ii) dëmin e palës kundërshtare, dhe që nuk ishin paraqitur më herët në procedurë.
65. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore në lidhje me konstatimin e gjykatës së shkallës së dytë se *“është i pamohueshëm fakti se qëllimi i organit administrativ është për ta përfunduar raportin juridik”*, i cili konstatim sipas parashtruesi bie jashtë juridiksionit të saj me rastin e shqyrtimit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ në procedurë paraprake, Gjykata vëren se gjykata në fjalë në mënyrë shprehimore gjatë elaborimit të këtij argumenti ka theksuar se nuk paragjykon vlerësimin meritore të ligjshmërisë së vendimit të MBPZHR-së dhe se vlerësimi i vullnetit të saj për të përfunduar raportin juridik bëhet me qëllim të vlerësimit të kushteve ligjore në kuadër të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, respektivisht (i) interesit publik dhe (ii) dëmtimit të palës kundërshtare.
66. Gjykata po ashtu vlerëson se në rastet kur gjykatat e rregullta japin arsyetimin e tyre lidhur me një rast, shkalla në të cilën zbatohet kjo detyrë për të dhënë arsye mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit (shih rastin e GJEDNJ-së, [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29 dhe rastin e Gjykatës, KI195/20 me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, cituar më lart, paragrafi 139).
67. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë mundësitë procedurale për të adresuar pretendimet e tij dhe se në substancë, parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje ndaj pretendimeve thelbësore të tij të parashtruara në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, sa i përket plotësimit të kushteve ligjore për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së.
68. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që Aktgjykimi [ARJ-UZVP.nr. 44/2024], i 4 prillit 2024, i Gjykatës Supreme përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetim gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, në *“mungesë evidente apo të dukshme të shkeljes”*, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

II. Pretendimet përkitazi me pretendimin për shkeljen e të drejtës në pronë

69. Në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës në pronë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në të drejtën e pronës së tij, me ç'rast i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nga ku konstaton se koncepti i pronësisë përfshinë një gamë të gjerë të të drejtave që rrjedhin nga licencat dhe po ashtu nga drejtimi i një biznesi, si dhe që një kërkesë për kompensim mund të konsistojë në pasuri për shkak të pritjeve legjitime që një kërkesë e tillë të realizohet.
70. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon se ka të drejtën e pronës në investimet e mëdha që ka kryer në parcelën e dhënë me qira.
71. Në këtë kontekst, Gjykata do të vlerësojë më tej nëse parashtruesi i kërkesës, përkitazi me këtë pretendim e ka përmbushur edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së Punës.
72. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se praktika e GJEDNJ-së dhe e kësaj Gjykate, në parim, njeh tri kategori të rasteve kur kërkesa e paraqitur mund të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, përkatësisht; (i) “*mosshterimi procedural*” (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI219/21](#), me parashtrues *Isuf Ferati*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafët 26 dhe 28; dhe [KI193/20](#), me parashtrues *Bujar Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 majit 2021, paragrafët 26-28; dhe rastet e GJEDNJ-së, *Civet kundër Francës*, kërkesa nr. 29340/95, Aktgjykim, i 28 shtatorit 1999, paragrafi 41; *Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë*, kërkesat nr. 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04, 21819/04, Vendim, i 10 marsit 2010, paragrafët 69 dhe 97); (ii) “*mosshterimi substancial*” (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI71/22](#), me parashtrues *Muhamet Mehmeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 nëntorit 2023, paragrafët 53-57; [KI155/18](#), me parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50; dhe rastet e GJEDNJ-së *Haxhia kundër Shqipërisë*, nr. 29861/03, Aktgjykim, i 8 tetorit 2013, paragrafët 149 dhe 152; *Castells kundër Spanjës*, nr. 11798/85, Aktgjykim, i 23 prillit 1992, paragrafi 32; *Ahmet Sadik kundër Greqisë*, nr. 18877/91, Aktgjykim, i 15 nëntorit 1996, paragrafi 33; *Gäfgen kundër Gjermanisë*, nr. 22978/05, Aktgjykim, i 1 qershorit 2010, paragrafët 142, 144 dhe 146); dhe (iii) “*kërkesë e parakohshme*” (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI09/19](#), me parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafët 40-43; [KI179/20](#), me parashtrues *Telekomi i Kosovës Sh.A*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 janarit 2021, paragrafi 95; dhe [KI49/22](#), me parashtrues *Zejnel Ninaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 gusht 2023, paragrafi 59; dhe rastet e GJEDNJ-së *Bilsena Šahman kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, kërkesa nr. 40110/16, Vendim, i 25 prillit 2017 dhe *Alenka Šaver kundër Sllovenisë*, kërkesa nr. 18105/13, Vendim, i 7 shkurtit 2017).
73. Në rastin konkret, Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi për iniciimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Komerciale me ç'rast kërkoj nga ajo anulimin e vendimit të MBPZHR-së për lirimin e pronës së saj për shkak të investimeve që i ka kryer në parcelën e dhënë me qira.
74. Gjykata po ashtu rikujton se bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës parashtrroi edhe një padi për kompensim të dëmit kundër MBPZHR-së, në esencë si rezultat i mos vazhdimit të kontratës së qirasë, gjë e cila sipas tij, e dëmton financiarisht

për shkak të investimeve të kryera në parcelën e dhënë me qira, me ç'rast edhe aty propozoi vendosjen e masës së sigurimit.

75. Gjykata thekson se, Gjykata Komerciale dhe Gjykata Supreme gjatë trajtimit të kërkesës së parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MBPZHR-së, në procedurë paraprake administrative, nuk vendosën nëse parashtruesit të kërkesës i është mohuar e drejta në investimet e tij të realizuara por vendosën vetëm mbi kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ. Gjykata thekson se çështja e të drejtës së parashtruesit përkitazi me investimet e kryera në pronën kontestuese është në fazën e shqyrtimit në Gjykatën Komerciale.
76. Një rrethanë e tillë, Gjykata e cilëson kërkesën konkrete si kërkesë të kategorisë së tretë, përkatësisht "*kërkesë e parakohshme*", sipas praktikës gjyqësore të lartpërmendur të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.
77. Gjykata thekson se ky konstatim i Gjykatës nuk paragjykon rastin e parashtruesit përkitazi me padinë e tij dhe nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish të dorëzojë kërkesë kushtetuese në lidhje me këtë pretendim brenda afatit ligjor pas shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
78. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton që pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në pronë të cilësohet si kërkesë e kategorisë së "*kërkesës së parakohshme*", dhe rrjedhimisht, kërkesa refuzohet në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 21 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me pikën (b) të paragrafit (1) dhe paragrafin (2) të rregullit 34 si dhe pikën (b) të paragrafit (1) të nenit 48 të Rregullores së punës, më 30 tetor 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Jeton Bytyqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani